



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1068  
Dt. Rregj. 06.03.2015

Nr. Vendimi 980  
Dt.Vendimi 16.12.2015

**V E N D I M**  
**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare séance Borana Liti sot me datë 16.12.2015, ora 10.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. rregj. them. 1068 datë 06.03.2015 që l përket palëve ndërgjyqëse:

- PADITËSE:** Shoqëria "ARIFI" sh.p.k., identifikuar me NIPT J667030870, me seli ne L."Liria", Rr."Mbreti Genti", Shkoder, perfaqesuar nga administratori Z.Xhevdet Amuli.
- TE PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder,përfaqshuar nga znj. Siriana Bakushi.  
Drejtoria e Apelit Tatimor Tirane, përfaqshuar nga znj. Siriana Bakushi.
- OBJEKTI:** Kerkohet shfuqizimi i aktit,Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.8196/1 prot., date 13.10.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder dhe shfuqizimi i vendimit nr.29309/1 date 05.02.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.
- BAZALIGJORE:** Nenet 17/a,7/a,15/a te ligjit 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative". Neni 31,32 e vijues i K.Pr. Civile,neni 109 i ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedural Tatimore ne R.Sh. ".

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi administroi provat shkresore te paraqitura, dëgjoi palën paditese në pretendimet përfundimtare i cili kërkon pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj ,përfaqshuesen epalës së paditur që kërkoj rrëzimin e kërkesë padisë si të pa bazuar në ligjë dhe ne prova,shqyrtoi dhe analizoi çështjen ne teresi:

## VEREN se;

Paditësi Shoqëria "Arifi" sh.p.k, me administrator , Xhevdet Amuli I është drejtuar Gjykates Administrative Shkalle Pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me objekt "shfuqizimi i aktit, njoftim vlerësimit nr.8196/1 prot datë 13.10.2014 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizim i vendimit nr.29309/1 datë 05.02.2015 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor".**

### **Rrethanat e ceshajes;**

Shoqëria "Arifi" sh.p.k është person juridik, me objekt aktiviteti "tregti të karburanteve, tregtim me shumicë e pakicë të vajrave lubrifikantë për automjete .

Grupi i punës së Hetimit tatimor në bazë të Urdhrit të punës nr.293 prot datë 20.08.2014 si dhe Urdhrit të punës nr.1165 prot datë 21 – 31 /08/2014 të D.R.T-ve Shkodër ka ushtruar kontroll pranë subjektit Shoqëria "Arifi" sh.p.k, me numër Nipti J667030870, në pikën e karburantit me adresë Lagj. "Liria"; Rr. "Mbreti Gent" dhe ka mbajtur Akt Konstatimin me numër serie 0441728, 0441729, 0441730 datë 22.08.2014.

Sipas konstatimit të mbajtur nga grupi i kontrollit, subjekti ushtronte veprimtari pa vendosur paisjen fiskale përse shprehet në këtë akt.

Referuar Akt Konstatimeve me numër serie 0441728, 0441729, 0441730 datë 22.08.2014 ndër të tjera, citohet nga përmbajtja e tyre :

*Pompa Nr.5 ka të instaluar 1 (një) pistoletë, e cila shërben për shërbim GAZ dhe është në gjendje pune dhe është e pa paisur me kasë fiskale për shitjet që kryen me para në dorë.*

*Pompa Nr.7 ka të instaluar 4 (katër) pistoleta nga të cilat 2 (dy) pistoleta janë në gjendje pune të palidhura me kasë fiskale, 2 (dy) pistoletat e tjera janë të bllokuara nga DPM me numër vulash 0020248, 0020281 dhe vula me numër 0020248 është e dëmtuar.*

*Pompa Nr.8 ka të instaluar 1 (një) pistoletë, e cila është në gjendje pune dhe e palidhur me kasë fiskale për shitjet me para në dorë.*

Sipas Akt Konstatimit me numër serie 0441728, 0441729, 0441730 datë 22.08.2014 është përqyruar gjendja në fakt e konstatuar pranë subjektit .

Me njoftim-vlerësimin nr.8196/1 prot dt.13.10.2014 subjekti është njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me detyrime, gjoba në vlerën 300 000 lekë, për periudhën tatimore 2014/08 për "mospajse me kasë fiskale", në zbatim të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 122 pika 1, gërma (a / i).

Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me vendimin e saj nr.29309/1 prot datë 05.02.2015 ka vendosur :

Lënien në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi, njoftim vlerësimit nr.8196/1 prot dt.13.10.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Paditësi ne gjykim kerkoi pranimin e kerkese padise sipas kerkimeve ne padi ndersa ana e paditur kerkoi rrezimin e kerkese padise duke I qendruar parashtrimeve te parashtruar me shkrim para gjykates.

### **Ne gjykim gjykata konstatoi se;**

Gjate shqyrtimit gjyqsore ne gjykim nga pala paditese eshte paraqitur kopja origjinale (ne ngjyre te verdhe) e akteve te konstatimit 0441728, 0441729,0441730, qe

mbajne si date perpilimit te akt - konstatimit dt 22.03.2014 ,( jo dt 22.08.2014) te perpiluar nga inspektoret Alfred Koromani, Erald Baholli dhe Mario Berberi .

Referuar akteve te depozituar ne gjykata me cilesine e proves nga ana e paditur DRT-Shteter dhe te njesuara me origjinalin nga vete kjo drejtori, rezultoi se aktet e konstatimit me nr 044.1728, 0441729,0441730, mbajne dt 22.08.2014 lehtesisht te lexueshme ne te dy praktikat.

I pretenduar nje fakt I tille nga ana paditese ne gjykim se data e perpilimit te akteve te konstatimit dt 22.08.2014 e paraqitur ne gjykim nga ana e organit administrative ne fotokopje te njesuar eshte e korigjuar, pasi ne kopjen origjinale qe lihen tek subjekti tatimpagues (flete e verdhe ) aktet 0441728, 0441729,0441730, mbajne dt 22.03.2014 qartesisht te lexueshme, gjykata I kerkoi anes se paditur , (per kqyerje )qe te paraqese kopjen origjinale ( flete te kuqe ) qe mbahet nga vete drejtoria, me qellim te verifikimit te kesaje mosperputhje te dukshme te dates ne mbajtjes se akteve te konstatimit ( jo dt 22.08.2014 sipas fotokopjeve te njesuara po dt 22.03.2014 origjinale (fteta e verdhe).

Nga ana e paditur ne seance gjyqsore te dt 16.12.2015, jo vetem nuk eshte paraqitur kopja origjinale e akteve te konstatimit 0441728, 0441729,0441730, dt 22.03.2014 , por eshte konfirmuar se I permbahen dokumentacionit te depozituara ne gjykate me dt 06.08.2015 te njesura me origjinalen nga vete institucioni duke mbajtur qendrimin se akt-konstatimet 0441728, 0441729,0441730 jane mbajtur me dt 22.08.2014 dhe jo sipas asaje qe pasqyron paditesi ne kopjen (flete te verdhe) origjinale te paraqitur para gjykates me dt 22.03.2014.

Referuar nenit 35 e 37 te ligjit 49/ 2012

#### **Neni 35**

##### **Barra e proves**

**1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.**

2. Organi i administratës publike ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi.

3. Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj. Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.

#### **Neni 37**

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

**1. Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.**

2. Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkojnë nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

- a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;
- b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;
- c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

4. Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, gjykata zbaton legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.

Gjykata vlereson se është pikerisht organi administrative DRT-Shkoder dhe DPT-Tirane që kanë barrën e proves për paraqitjen e akteve provuese para gjykates në lidhje me ligjshmërinë e aktit administrative në kuptim në dispozitave të siper cituara, për të provuar ligjshmërinë e aktit administrative që kontestohen në gjykate, dhe se duke iu kthyer rastit në gjykim ana e paditur megjithë detyren që ka në baze të ligjit 49/2012 dhe të urdherit të gjykates për të praqitur në gjykate aktin e konstatimit 0441728, 0441729, 0441730, dt 22.08.2014, në kopjet e tyre origjinale për të konstatuar saktësisht datën e mbajtjes së tyre nëse ato janë me dt 22.08.2014 apo dt 22.03.2014 (sipas kopjes flete e verdhe origjinale të depozituar nga paditesi) ana e paditur jo vetëm nuk i ka paraqitur por dhe ka mbajtur qëndrimin për vlefshmërinë e fotokopjeve të njesuara me origjinalin të paraqitura me cilesinë e proves në gjykate me dt 06.08.2015.

Nga sa më lart analizuar akt-konstatimet 0441728, 0441729, 0441730, dt 22.03.2014 që duhet të vleresohen nga gjykata janë ato të paraqitura në original nga vete paditesi pikerisht (0441728, 0441729, 0441730, dt 22.03.2014, (flete e verdhe), ku qartazi me shikim, me sy të lire shihet se data mbajtjes së akteve të konstatimit është dt 22.03.2014 dhe jo dt 22.08.2014, gje kjo që i ben keto akte absolutisht të pa vlefshme për shkak të mos përputhjes së momentit të perpilimit të akt-konstatimeve me urdher të sherbimit nr 293/prot dt 20.08.2014, mbi bazën e të cilit është ushtruar dhe kontrolli, ku përveç të tjerash për këto kontroll mungon dhe urdher - punë ditore, që duhej të bashkangjitet urdher sherbimit nr 293/prot dt 20.08.2014.

Pra nuk mund të perpillohet një akt konstatimi në një tjetër datë nga ajo që parashikon urdheri i sherbimit dhe urdheri i punës (mungon), që në rastin në shqyrtim ka mos përputhje të dukshme.

Qëndrimi i anes së paditur, për vlefshmërinë e akteve të korigjuara të paraqitura me cilesinë e proves në gjykate, bie ndesh me nenin 35 të ligjit 49/2012, ku dhe organi administrativ ka barrën e proves, për aktet që prodhon vete ai.

**Ne ligj është rregulluar pavlefshmeria e aktit administrativ në aspektin material.**

**Neni 116 i tij shprehet në lidhje me 'Aktet administrative absolutisht të pavlefshme':**

*"Aktet administrative do të quhen absolutisht (e pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:*

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapercim të kompetencave të tij ligjore
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kerkuar nga ligji.



Pra jemi ne kushtet e nenit 116/c, pasi njoftim vleresimi tatimore nr 8196/1 prot dt 13.10.2014, jane rrjedhoje e akt-konstatimeve te pa verteta dhe te korigjura, te mbajtura jo ne perputhje me ligjit 9920/2008, qe ngushteson veprimin e administrates tatimore sipas urdherit te sherbimit dhe te punes ne te njejten date qe parashikon urdheri dhe jo te nje date tjetër, per pasoje kjo pavlefshmeri e akt-konstatimit sjelle ligjerisht dhe pavlefshmerine absolute te cdo akti tjetër te dale ne baze te ketyre akteve (veprimeve administrative) .

Perfundimisht gjykata vendos shfuqizimin e aktit, njoftim vlerësimit nr.8196/1 prot datë 13.10.2014 te Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizimin e vendimit nr.29309/1 datë 05.02.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor”, si akte absolutisht te pa vlefshme, prandaj

**PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenin 45 te ligjit nr 49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative” 126 , 306 dhe 310 të K. Pr. Civile

**VENDOSI**

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e aktit, njoftim vlerësimit për detyrim tatimore nr.8196/1 prot datë 13.10.2014 te Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizimin e vendimit nr.29309/1 datë 05.02.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor”, si akte absolutisht te pa vlefshme.

-Shpenzimet gjyqsore sic janë bërë.

-Ky vendim përbën titull ekzekutiv, është i formës së prerë dhe do te ekzekutohet menjëherë.

Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

**Shkodër me datë 16.12.2015**

**SEKRETARE SEANCE**  
Borana LITI



**GJYQTARE**  
Valbona DURRAJ